



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 22492 prot.

Shkodër, më 03.11. 2025

**VENDIM
Nr. 64, datë 31.10.2025**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 76, DATË 19.12.2024, “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2025–2027 TË BASHKISË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të VKB-së nr. 15, datë 20.07.2023, “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a., si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”; të VKB-së nr. 28, datë 29.05.2025, “Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare Bio Strajca, në pronësi të Bashkisë Shkodër”; të ligjit nr. 115/2024, datë 03.12.2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; të VKB së nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar; si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit në buxhetin e miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, programi AC141 Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural, fisha P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese, sipas fishës bashkëngjitur, si më poshtë:

- Pakësimi

		<u>Pakësim në lekë</u>	2025	
Institucioni	Pr.	Emërtimi i Aktivitetit	Investime 231	Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	PAC141(04220).Q2.O1.A1 1 Trajtimi i qenve të rrugës (Shtesë) - e trashëguar Nënaktiviteti A3 Ndërtim i strehëzës së re të qenëve dhe Rrethim oborri strehëza e qenëve dhe kolibe për qen – zbatim	690,000	690,000
		TOTALI	690,000	690,000

- Shtesa

		<u>Shtesa në lekë</u>	2025	
Institucioni	Pr.	Emërtimi i Aktivitetit	Transferta	Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese (Shtesë) A.4 Mbështetje financiare për Sh.a. Skodrinon, për Tregun Rus	690,000	690,000
		TOTALI	690,000	690,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota

Vota Pro	39
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	1
Zbardhur me datë	03.11.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

Oltion LULI

